

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE MITROVICË
OSNOVNI SUD MITROVICI - BASIC COURT OF MITROVICA

P.nr.883/2016

NE EMER TE POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE Departamenti i përgjithshëm Gjyqtarin Bekim Veliqi, procesmbajtësja Valdete Sadiku, duke vodosur në lëndën penale ndaj të pandehurit [REDACTED] nga fshati Zhabar i Poshtëm Komuna Mitrovicë, për shkak të veprës penale Dëmtim i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK, duke vodosur lidhur me Aktakuzën e Prokurorisë Themelore ne Mitrovica Departamenti përgjithshëm PP.II.nr.374/2014, dt.29.12.2016, dhe keresën për shqiptimin e urdhrit ndeshkimor të paraqitur në Aktakuze, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, me datë 23.01.2017, merrë këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore ne Mitrovica Departamenti i përgjithshëm PP.II.nr.374/2014, dt.29.12.2016 dhe kjo Gjykate i jep ketë;

URDHER NDESHKIMOR

I akuzuari;

[REDACTED] i lindur me dt.08.05.1972, ne fsh.Zhabar i Poshtëm Komuna e Mitrovice me vendbanim ne rr. [REDACTED], pn, me nr.personal [REDACTED], pronar i [REDACTED], me seli ne Mitrovica, i martuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës se Kosovës, i gjendjes se mesme ekonomike.

ËSHTË FAJTORË

SEPSE: Ne mes te dt. 09.02.2010 dhe 26.06.2014, ne Mitrovica me qellim te pamundësimit qe te dëmtuarës –kreditorit NLB Prishtina për arkëtimin e shumes se kredisë se pakthyer ne shume prej 10.000,00€ (dhjejtemijeeuro) me kamate 14%, ne afat kthimi prej 24 muajve ashtu qe ka tjetërsuar pengun nr.K0710/867, te cilin e ka lene peng tek e dëmtuara për te siguruar kthimin e kredisë se marre dhe pse ka qene në dijeni se nuk ka te drejtën ta tjetërsoj ashtu qe me ketë i ka shkaktuar te dëmtuarës déme ne shumë prej 4.406,46€, ndërsa vlera e sendit te lene peng sipas marrëveshjes per pengun nr./K010/867, dt.09.06.2010, per sendet e tjetërsuar ka shumen prej 2.667,00€.

Me ketë ka kryer veprën penale Dëmtim i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.2 lidhur me par.1 te KPRK-es.

I. Andaj gjykata ne baze te nenit 4, 7, 17, 41, 46, 73, te KPRK-se, dhe nenit 359, 360, 361, 365, 366, dhe neneve 493, 495 te KPP-ës, i

S H Q I P T O N

DENIM MË GJOBË ne shumë prej 1000€ (njemijeeuro), te cilin dënim do ta paguaj ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse i akuzuari nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, Gjykata do te veproj ne baze te nenit 46 te KPRK-se, dhe deri ne zëvendësimin e dënimit me gjobë me dënim me burgim duke illogaritur 20€ për një ditë të kaluar me burg.

Obligohet i akuzuari qe te dëmtuarës NLB Prishtina, ti kompensoj demin ne shumen prej 2.667,00€,(dymijegjashteqindegashtedhjeeshtateuro), ne afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi nen kërcënimin e përmbarimit te dhunshëm, ndërsa për kërkesën tjetër pasurore juridike pala e dëmtuar udhëzohet ne kontestin civilo-juridik.

I akuzuari obligohet që në emër te shpenzimeve e procedurale te paguaj shumen prej 20€, si dhe ne emër te paushallit gjyqësorë te paguaj shumën prej 20€, ne afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Arsyimet

Prokuroria Themelore ne Mitrovice Departamenti i përgjithshëm, ka parashtruar Aktakuzën PP.II.nr.374/2014, dt.29.12.2016, se bashku me kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, kundër te pandehurit [REDACTED] nga fshati Zhabar i Poshtëm Komuna Mitrovicë, për shkak të veprës penale Dëmtim i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.1 të KPRK.

Gjkata shqyrtoj Aktakuzën dhe kërkesën për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor dhe gjeti se Aktakuza dhe kërkesa janë të bazuar ne baze te nenit 495 te KPP-se, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPP-ës, që pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësor të merr vendim për urdhër ndëshkimorë si në dispozitiv, kjo vërtetohet nga provat qe i janë bashkangjitur aktakuzës, dhe atë Kontrata per Kredi biznesi nr.K0710/867, dt.09.06.2010, marrëveshja mbi pengun nr.k0710/867, dt.09.06.2010, procesverbal i gjykates nr.E.436/2012, dt.26.06.2014, ku konstatohet se sendet e lëna peng, janë shitur, te gjitha këto prova vërtetojnë fajësinë e te akuzuarit se ka kryer veprën penale e cila i vihen në barrë sipas aktakuzës se Prokurorit te Shtetit.

Sipas KPRK-se, vepra penale Dëmtim i të drejtave pronësore të personit tjetër nga neni 344 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, denimi per kete veper penale eshte së kryresi denohet me gjobe ose me burgim deri ne tre (3) vjet

Gjkata në përputhje me nenin 73 të KPRK-se, me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit me globe, mori për bazë gjendjen materiale dhe kushtet ekonomike për te akuzuarin, vlerësoj se një dënim i tillë është adekuat dhe është i përballueshëm në raport me gjendjen e tij ekonomike dhe me këtë dënim do te arrihet qëllimi i dënimit, i cili parashihet me nenin 41 te KPK-ës, pasi qe njëra nga qëllimet e dënimit është te parandaloje kryesin nga kryerja e veprave penale ne te ardhmen dhe te beje rehabilitimin e tij dhe se te përbajë personat e tjere nga kryerja e veprave penale ne ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit dhe nga te gjitha këto ka konsideruar se dënim i shqiptuar është ne përputhshmëri me shkallen e përgjegjësisë dhe te rezikshmerisë shoqërore për veprën penale për te pandehurin.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor, gjykata e mori komfor nenit 450 te KPP-ës, ndërsa per kërkesën pasurore juridike u vendos ne mbështetje te nenit 458 e lidhur me nenin 463 te KPP-se, është vendosur për kërkesën pasurore juridike, ndërsa për pjesën tjetër Gjkata te dëmtuarën e ka udhëzuar qe kërkesën pasurore juridike mund te realizojnë ne kontestin civilo-juridik ne mbështetje te nenit 463 te KPP-ës

Nga theksimet e theksuara si me larte u vendos si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE

Departamenti i përgjithshëm
P.nr.883/2016 dt.23.01.2017

Procesmbajtjesia
Valdete Sadiku

Gjyqtari
Bekim Veliqi



Këshilla Juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala ka te drejtë kundërshtimi, ne afat prej 8 (tete) ditësh, nga dita e pranimit, kundërshtimi i parashtronhet kësaj gjykate